

## STATUT

### I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “2XL Marketing” sh.p.k.

Sot, më datë 21.11.2023, u vendos për sa më poshtë vijon:

**Z.Juljus Ajazi** i biri i Saimir, shtetas shqiptar, lindur me 02.09.1998 dhe banues ne adresën: Rruga “Teuta” Lagja 13, Rajoni 5, Durres, mbajtes i leternjoftimit ID me nr. J80902059A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

vendosi të nënshkruaj Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar aktiviteti i së cilës rregullohet në përputhje me legjisacionin e Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me dispozitat në vijim:

#### Kreu I Emertimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

##### Neni 1: Emërtimi

1.1 Emertimi i shoqerise eshte “**2XL Marketing**” sh.p.k, ketu e me poshte e quajtur shoqeria.

Shoqeria eshte themeluar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjisacionin shqiptar.

1.2 Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit.

1.3 Shoqeria do te ushtroj aktivitet ne perputhje me legjisacionin shqiptar, Aktin e Themelimit dhe Statutin

##### Neni 2 Objekti

*Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :*

Aktivitet në fushën e marketingut në Web. Prodhim dhe studim i shërbimeve të marketingut. Marketing të shërbimeve pa kufizime territoriale, të shërbimeve të komunikimit që rrjedhin nga zvillimi i teknologjive; Aktivitet në fushën e ofrimit të shërbimeve të ndryshme online. Aktivitet ne fushen e grafik dizajner. Aktivitet kërkimor, përzgjedhje, orientim, trajnim dhe aktivitete profesionale trajnimi me sisteme në largësi dhe multimediale; Aktivitet në fushën e tregtisë elektronike edhe për llogari të palëve të treta. Aktivitet ne fushen e krijimit, hostimit dhe mirembajtje faqe internet. Ne funksion te nje game te gjere sherbimesh online.

Ofrim i trajnimeve inovative per te rinj per marketing online dhe mirembajtje rrjete sociale per biznese apo individe.

Krijimi, mirembajtja dhe menaxhimi i faqeve te internetit per te trete, perfshire shoqeri tregtare vendase dhe te huaja.

Projektimi, konsulenca, ndermjetesim dhe realizimi dhe nenkontraktimi i sherbimeve te call center, si inbound dhe outbound. Projektimi, administrimi dhe shit-blerja e produkteve dhe sherbimeve telematike, informatike dhe te marketingut, ne fushen informatike telefonike, informatike dhe tregtare. Administrimi dhe tregtimi i bankave te te dhenave te finalizuara per marketing. Perfaqesimin dhe sherbime ne fushen e telekomunikacioneve dhe te prodhimeve e

sherbimeve telematike; Projektim dhe realizimi software dhe/ose hardware, tregtimi dhe dhenia me qira e tyre, si edhe asistencë per shqyrtim.

Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të cilat nuk ndalojnë nga ligji në fuqi, të vlefshme dhe me interes për Shoqërinë, me anë të pajisjes me licencat e nevojshme.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do te jete e pacaktuar .

**Neni 4**  
**Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: pasuria numër 8/651+2-N9, me sipërfaqe ndërtuese 188.9 m<sup>2</sup> (njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë nëntë) metër katror, në adresën: Rruga e "Kavajës", zona kadastrale 8220, Tiranë, sipas certifikatës së pronësisë nr.1839506, lëshuar me datë 22/11/2018.

**Kreu II**  
**Kapitali**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 Lekë.

Pjesëmarra e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaket themelues jane;

**Z.Juljus Ajazi** i biri i Saimir, shtetas shqiptar, lindur me 02.09.1998 ne Durres ,banues ne Adresen Rruga "Teuta" Lagja 13, Rajoni 5, Durres mbajtes i leternjoftimit Id me nr. J80902059A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, zoterues i 1(nje) kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise me vlere 100 leke.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;



- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8 Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e)
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10 Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë



vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 Administrimi**

- a) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- b) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- c) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

**Z.Juljus Ajazi** i biri i Saimir, shtetas shqiptar, lindur me 02.09.1998 ne Durres dhe



banues ne adresën Rruga "Teuta" Lagja 13, Rajoni 5, Durrës, me nr.cel 0692272968, email [2xlmarketing98@gmail.com](mailto:2xlmarketing98@gmail.com) dhe mbajtes i leternjoftimit Id nr. J80902059A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

#### **Neni 14 Kompetencat e Administratorit/ëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratim;
- f) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratim e shoqërisë tregtare;
- g) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivitet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përmiratim, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmiratim, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfundimisht përmiratuar gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, përmiratuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mënyrë;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm përritjet e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, përmiratuar në mënyrë;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;



- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- g) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- h) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti finanziar-ekspertet**

##### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **Kreu V Prishja -riorganizimi i shoqërisë Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tē behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim tē Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave tē falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare pēr dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë nē pērputhje me pikën 3 tē nenit 43 tē ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Pēr Qendrën Kombëtare tē Regjistrimit";
- d) me vendim tē gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne tē cilin parashikojne menyren e likuidimit tē shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument tē nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit nē gjendjen e aftësisë paguese, me pērjashtim tē rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim pēr emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, pēr tē caktuar një likuidues.

#### **Neni 19 Riorganizmi i shoqërises bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund tē ndahet, bashkohet sipas Vendimit tē Mbledhjes së Përgjithshme tē Asamblesë së Ortakëve, nē pērputhje me dispozitat ligjore tē parashikuara nē Pjesën IX tē Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Pēr tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 20 Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 21 Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

#### **Neni 22 Te ndryshme**

Ky Statut eshte hartuar ne 3 kopje ne gjuhen shqipe.

Ky Statut u nenshkrua lirisht nga pala ,duke shprehur vullnetin e lire dhe te plete.

#### **ORTAKET**

**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"2XL Marketing" sh.p.k.**

Jeljus Ajazi